



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1436/1 Prot

Elbasan më 03 /04/2025

VENDIM

Nr. 31 datë 02 /04/2025.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHKURT 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin SHKURT 2025, 81 familje me fond 230.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale
Drejtori Juridik

D.Shuli
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë 02.04.2025

Pro 25

Kundër -

Abstenim -



1486/2

08.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 4641 Prot

Elbasan, më 7.4.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.31, datë 02.04.2025 " Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Shkurt 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 1485/1 Prot

Elbasan më 03 /04 / 2025

VENDIM

Nr. 32 datë 02 /04 / 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHKURT 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin SHKURT 2025 gjithsej 261 familje me një fond prej 1.342.671 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli

Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



Miratuar datë 02.04.2025

Pro 25

Kundër —

Abstënim —

1485/2
08.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 465/1 Prot

Elbasan, më 7.4.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.32, datë 02.04.2025 “ Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1456/1 Prot.

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Dt. 03.04.2025

V E N D I M

Nr. 33 datë 03 . 04 2025

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”

Në mbështetje të neni 27 pika 5 e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar; ligjit nr.57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 30 pika 4/c, i ndryshuar; VKM nr.1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr.290, datë 30.04.2004 “Për Miratimin Strategjik Kombëtar dhe Menaxhimin e Zjarreve në Pyje e Kullota”; VKM nr.1080, datë 22.12.2010 “Për Rregullat në Parandalimin Dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota si dhe për krijimin e Njësive Vullnetare të Shuarjes së Zjarreve”; VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar.

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar të bashkisë Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria MNZSH_së, Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale, Agjencia e Emergjencave Civile, Njësiti Administrativ të bashkisë Elbasan dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale (ASHPR).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

KRYETAR

Lutfi Lala



Konceptoi: Xh. Muça

Pranoi: J. Bodurri

Miratoi: K. Gripshi

Konfirmoi: A. Cenolli

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02 / 04 2025

1456/1

10.04.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE
KRIZAVE

Nr. 466/1 Prot.

Elbasan, më 9. 4. 2025

Lënda: Konfirmim Akti.

BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Elbasan

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan, Nr.33 datë 02.04.2025, me Lëndë: "Për miratimin e Planit të parandalimit dhe shuarjes së zjarreve në fondin pyjor kombëtar, bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA